

Të nderuar kolegë auditues,

KLSH organizon këtë analizë vjetore të punës, **si një traditë e mirë**, në frymën e përparësive të nënvizuara nga Kongresi XXIII-të i INTOSAI, me angazhimin për progresin e vazhdueshëm të auditimit të qeverisjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të Institucioneve moderne të Auditimit.

“Institucionet Kombëtare të Auditimit (SAI) duhet të përgjigjen ndaj një qeverisjeje në ndryshim dhe, duke bërë këtë, ata u përgjigjen sfidave kombëtare dhe globale të zhvillimit”,- është nënvizuar në Deklaratën e INCOSAI-t XXIII të Shtatorit 2019. Pikërisht, këtë mesazh kuptimplotë të Kongreseve XXII dhe XXIII të INTOSAI-t jemi përpjekur të vitalizojmë, në përballje me detyrat dhe sfidat tona kryesore gjatë vitit që u mbyll.

KLSH vjen sot në këtë analizë vjetore të përgjithshme, pas kryerjes së analizave në secilin prej departamenteve të auditimit, nga diskursi i të cilave kemi përmbledhur gjetjet, sugjerimet dhe vërejtjet ndaj punës dhe qasjes sonë, qasje e asistuar dhe nga ana e ekspertëve të shoqërisë civile të pranishëm në analizat e departamenteve, të cilët i falënderojmë për pjesëmarrjen dhe kontributin.

Vizioni i institucionit tonë, **“KLSH-agjent *watchdog* i Parlamentit dhe shërbëtar i qytetarit”** është në të njëjtën linjë me moton e INTOSAI-t **“Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare dhe jo të qeverive”**. Bazuar mbi këtë vizion dhe filozofi të konsideruar si forca lëvizëse dhe inspiruese për menaxhimin e ndryshimit brenda nesh, veprimtaria jonë gjatë vitit të kaluar ka synuar në përmirësimin e menaxhimit financiar, administrimit publik dhe të kontrolleve të brendshme, duke kontribuar në qeverisjen e mirë dhe promovimin e llogaridhënies, nëpërmjet forcimit e rolit të KLSH, në luftën pa kompromis kundër korrupsionit dhe ushqimin e një kulture pune të tillë si pjesë e këtij projekti kombëtar, në të gjithë nivelet e qeverisjes shtetërore.

Të nderuar drejtues të institucioneve dhe auditues publikë!

2019 duke shënuar vitin e tetë në rrugëtimin e nisur së bashku në fund-vitin 2011, pavarësisht mungesës së finalizimit të vendimmarrjes nga politika e lartë shtetërore për zgjedhjen e Kryetarit të ri të KLSH, veprimtaria e institucionit është kryer duke respektuar Kushtetutën dhe ligjin organik të KLSH-së, e cila falë punës dhe përkushtimit Tuaj, ka siguruar vijimësinë e konsolidimit si institucion modern i auditimit të jashtëm në Shqipëri.

Në **planin e zhvillimeve të brendshme të KLSH**, vokacioni i vijueshmërisë, normalitetit dhe aktiviteti intensiv i punës për arritjen e targeteve të vendosura si synim, është mbështetur nga partneret tanë ndërkombëtare, Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), Zyra e Auditimit Qeveritar të SHBA-së (GAO),

SIGMA, EUROSAI dhe INTOSAI. Në këtë aspekt, KLSH ka mundur të ruajë dhe sigurojë integritetin e proceseve dhe procedurave, nëpërmjet:

1. Mbulimit me auditim të të gjithë aspekteve të domosdoshme, duke përbushur shtrirjen e auditimeve, ku përgjatë vitit 2019 rezultojnë të evaduara dhe në proces **160 auditime në numër** dhe sipas llojeve e departamenteve, duke realizuar projeksionet për numrin e angazhimeve audituese në institucionet e qeverisjes së përgjithshme, në njësitë e pushtetit vendor, në administratën tatimore dhe doganore, në shoqëritë me kapital shtetëror, etj. Në këtë prizëm,

✓ **A. Auditime Financiare me Opinion:**

Në linjë me sugjerimet dhe rekomandimet e raport progresit të BE për auditimin e jashtëm publik, si dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, në akord me praktikën më të mira të kohës, është shtuar vëmendja ndaj **auditimeve financiare me dhënie opinionimi mbi rregullshmërinë dhe besueshmërinë** e pasqyrave dhe deklaratave financiare të entiteteve të audituara, në referencë me standardin ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”. Kështu, në v.2019 u përmbyllën **23 auditime financiare (sipas planit vjetor) me dhënie opinionimi, ose e thënë ndryshe, 2 herë më shumë se vitin 2017 dhe 3 herë më shumë se në vitin 2016.**Nga këto auditime në **7 raste ose 24 % të këtyre angazhimeve** janë dhënë opinione të pakualifikuara. Opinioni ka qenë i kualifikuar në **15 subjekte ose 71 % të këtyre auditimeve**, ndërsa në **1 rast**, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, grupi i auditimit të KLSH ka arritur në konkluzionin e një Opinioni të Kundërt.

✓ **B. Auditime të përputhshmërisë me Opinion:**

Bazuar në planin vjetor të auditimeve, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2019, KLSH ka kryer auditime përputhshmërie **42**, nga të cilat për 6 raste janë dhënë opinione të pakualifikuara; në 35 raste opinioni ka qenë i kualifikuar, ndërsa në 1 rast konkluzioni ka qenë për Opinion të Kundërt.

Janë përmirësuar ndjeshëm strukturat e aplikueshme të llojeve të auditimit, duke u dhënë më shumë prioritet në agjendën tonë auditimeve të së ardhmes, atyre të performances dhe atyre të teknologjisë informative. Në këtë mënyrë, **janë ulur angazhimet e pajtueshmërisë (ku p.sh nga 118-120 të tilla që realizoheshin mesatarisht në vitet 2015-2016, ato tani optimizohen në rangun afërsisht të 80 angazhimeve të këtilla; të ndara në auditime të pajtueshmërisë dhe të rregullshmërisë.**

✓ **C. Auditime të performancës:**

Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet të ndërmarra për **përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës.**

**Për vitin 2019, numri i auditimeve të performancës u rrit me 6% në krahasim me vitin 2016, si dhe u dyfishua ndaj vitit 2014 duke arritur në 16 auditime të kësaj tipologjie** Tashmë është konsoliduar Departamenti i Auditimit të Performancës në veprimtarinë e të cilit janë rrokur tema dhe çështje me impakt të ndjeshëm social si Cilësia dhe siguria e Barnave në Rrjetin e Hapur Farmaceutik dhe Shërbimin Spitalor, Efektiviteti i Programeve Sociale të Strehimit, Efektiviteti i Menaxhimit dhe Administrimit të Fondit Pyjor dhe Kullosor, Siguria Rrugore në Shqipëri, etj.

✓ **D. Auditime të Teknologjisë së Informacionit:**

Me Objektivin e parë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, institucioni ynë provoi të kalonte me sukses sprovën drejt një zhvillimi ambicioz, atë të **auditimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit.** si një lloj i veçantë i auditimit. Është krijuar Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe janë realizuar auditimet e këtij lloji, ndërkohë që është punuar për të miratuar kuadrin e plotë rregullativ dhe hartuar udhëzuesit metodologjik të nevojshëm, mbi të cilët realizohen auditime të tilla mjaft komplekse. **Auditimet e IT në vitin 2014 nuk aplikoheshin ende, ndërsa sot numri i tyre ka arritur në 7 auditime të dedikuara këtij lloji të veçantë auditimi , ose me një rritje prej 3 herësh ndaj numrit të auditimeve IT të kryera në vitin 2015, kuar ata startuan për herë të parë.**

**2. Indikator i dobishmërisë së auditimeve** të realizuara, e reflektuar kjo si në vlerën e gjetjeve, numrin e rekomandimeve të lëshuara dhe masave të zbatuara nga entitetet publike të audituara, por edhe në efektin e zbulimit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjshmërisë. Treguesi i dobishmërisë së auditimit njihet si raporti i sasisë së fondeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga SAI me shpenzimet buxhetore faktike të këtij institucio dhe është një nga treguesit më domethënës të performancës së Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Shtetëror.

Për vitin 2019 rezulton se për çdo një lek të shpenzuar për KLSH-në janë zbuluar dhe kërkuar për t'u zhdëmtuar **72.4 lekë.**

I analizuar për periudhën 8 vjeçare 2012-2019 rezulton se, **për çdo një lek të shpenzuar** për institucionin e KLSH-së është **kërkuar për t'u zhdëmtuar në arkën shtetërore 82,2 lekë**, ose 4 herë më shumë, nga 21.1 lekë që është kërkuar në periudhën 10 vjeçare 2002-2011).

**3.** Nga auditimet e kryera në vitin 2019, kemi identifikuar disa çështje thelbësore mbi qëndrueshmërinë e financave publike, të cilat, duke qenë se

vijojnë ndër vite, në mendimin tonë kërkojnë një vëmendje të shtuar të Kuvendit dhe Qeverisë. Më konkretisht, rezultatet e auditimeve të vitit 2019 sintetizohen në disa **indikatore themelore për veprimtarinë audituese të KLSH-së**, si vijon:

**3.a: Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me DËM EKONOMIK në shumën totale prej 27,3 miliardë lekë, ose 223,8 milionë euro.**

Puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe këtë vit, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me keq administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimit të pronës shtetërore e ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe inefficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, etj.

*Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve*

*Tabela nr.2*

<b>I. Dëm ekonomik në të ardhura</b>	<b>000/lekë</b>
Nga Shkeljet në Zbatimin e Legjislacionit Tatimor	113,650
Nga Shkeljet në Zbatimin e Kodit Doganor	959,514
Nga Keqadministrimi i Pronës Shtetërore të Dhënë me Qera dhe Koncesione	20,640,915
Të tjera	3,397,540
<b>Totali i Dëmit ekonomik në të ardhura</b>	<b>25,111,620</b>
<b>II. Dëm Ekonomik në shpenzime</b>	<b>000/lekë</b>
Në Shpenzimet për paga, Sigurime dhe Shpërblime	8,028
Në Shpenzimet Operative	416,013
Në Shpenzimet për Investime	1,678,989
Të tjera	90,127
<b>Totali i Dëmit ekonomik në shpenzime</b>	<b>2,193,158</b>
	<b>27,304,777</b>

**3.b:-SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE ME NDIKIM NEGATIV** në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej **130,5 miliardë lekë**, ose afërsisht **1,044.1 milionë euro**, nga e cila:

I. **46,6 miliardë lekë** në fushën e të ardhurave, kjo afërsisht **373.1 milionë euro**;

II. **83,9 miliardë lekë**, ose afërsisht **671 milionë euro**, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si

dhe shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keq menaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

4. Rezultatet e mësipërme të auditimeve të KLSH konfirmojnë përkeqësimin e ndjeshëm të perceptimit të publikut mbi nivelin e lartë të korrupsionit, i cili mbetet një nga problemet më serioze në zhvillimet demokratike të vendit, dhe që gërryen besimin publik duke cenuar drejtpërdrejt mirëqenien dhe prosperitetin e qytetarëve shqiptarë.

## 2. TREGUESIT E PERFORMANCËS 2019

### 2.1.-Auditimet

Për periudhën janar – dhjetor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përfunduar dhe evaduar **160 auditime**, nga të cilat janë evaduar **140**, sipas kësaj tipologjie:

- ✓ 41 auditime përputhshmërie dhe rregullshmërie;
- ✓ 42 auditime përputhshmërie;
- ✓ 23 auditime financiare;
- ✓ 16 auditime performance;
- ✓ 11 auditime tematike; dhe
- ✓ 7 auditime të IT.

Karakteristikë që duhet theksuar është, se me gjithë veçoritë që kanë karakterizuar vitin 2019, KLSH ka arritur që **të ruajë dhe të jetë mbi trendin mesatar të numrit vjetor të auditimeve të kryera në periudhën 2012-2019** prej mesatarisht 155 të tilla, gjë që rezulton me një përqindje të tillë realizimi. Veç kësaj, është rritur përqindja e auditimeve financiare, e numrit të auditimeve të performancës, kemi rritje të numrit të auditimeve IT, gjë e cila shpreh jo vetëm ecurinë e veprimtarisë audituese të KLSH në përputhje me kërkesat e BE-së, të përcaktuar në Raport-progresin e vitit 2019 për Shqipërinë, por dhe me dinamikat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit tonë.

Auditimet e KLSH janë kryer në një numër të konsiderueshëm prej **192 subjektsh**, qofshin këto institucione qendrore dhe njësi në varësi (Ministri dhe agjenci të ndryshme, drejtori qendrore dhe rajonale etj.); njësi të vetëqeverisjes vendore (bashki e qarqe), shoqëri publike në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve dhe duke e mbyllur me auditimin e projekteve me financim të huaj, etj., duke mbuluar të gjithë ciklin e veprimtarisë së tyre (të ardhurat dhe shpenzimet etj.), nga të cilat një peshë jo të vogël zënë auditimet e performancës.

<b>Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:</b>	<b>Nr</b>
☞ Institucione të qeverisjes qendrore	26
☞ Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	31
☞ Institucione të tjera financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e vartëse të saj	14
☞ Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	23
☞ Institucionet e administrimit të asetëve dhe mbrojtjes së mjedisit	23
☞ Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	17
☞ Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	58
<b>TOTALI I SUBJEKTEVE</b>	<b>192</b>

Në realizimin e këtyre auditimeve janë angazhuar rreth **170** auditues të profesioneve, përvojave dhe formimeve bazë të ndryshme, të kombinuar në numër sipas problematikave të subjekteve, nivelit të transaksioneve, madhësisë dhe rrisqeve që mbartin disa lloje aktiviteteve, ekspertizës për historikun e shkeljeve të mëparshme të ligjshmërisë për këto zyra e institucione publike, etj.

Nga ana e tjetër, bazuar në zbulimet e auditimeve të KLSH për vitit 2019, ku shkeljet me dëm ekonomik për parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, tregojnë fatkeqësisht se aktiviteti qeverisës vazhdon keqadministrimin dhe keqmenaxhimin e fondeve e të pasurisë publike, duke shmangur përgjegjësinë e llogaridhënien, si dhe duke cenuar rëndë mirëqenien e taksapaguesve dhe qytetarëve shqiptarë.

## **2.2.-Gjetjet kryesore 2019.**

I. Duke analizuar **dëmin ekonomik** të evidentuar gjatë vitit 2019, konstatohet se **në fushën e të ardhurave**, lidhur me shitjen, blerjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore është në shumën e përgjithshme prej 20,6 miliardë lekë.

a) Megjithëse administrimi i pronës publike është një koncept mjaft i gjerë, gjetjet më të rëndësishme në këtë grup kanë të bëjnë me dëmet dhe ineficencat më të mëdha të strukturave shtetërore. Vlera më e konsiderueshme në këtë kategori është evidentuar në **Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore**, në shumën 15,2 miliardë lekë, në pjesën më të madhe si pasojë e mungesës së lejeve nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të ndërtimit për 28 shoqëritë e kontraktuara për ndërtimin dhe shfrytëzimin e veprave hidroenergjetike, si pasojë e mungesës së propozimit

me vlerën përkatëse sipas detyrimit kontraktual të penalitetit, e mos lidhjes në kohë të kontratave shtesë nga ana e Ministrisë së linjës etj. Po ashtu dhe **Albpetrol SHA** në vlerën 5,4 miliardë lekë, si pasojë e mosrespektimit të kushteve kontraktuale të Marrëveshjeve Hidrokarbure për naftë bruto, gaz, apo shërbime të ofruara nga shoqëria, etj;

b) Në vijim, ka rezultuar se në zërin e klasifikuar “të tjera” dëmi ekonomik i rezultuar nga auditimet për vitin 2019 është në shumën e përgjithshme prej 3,4 miliardë lekë kryesisht nga **auditimi i ZVRPP dhe ALUIZNI-t** nga mungesa e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, mungesës së llogaritjes dhe mbajtjes së penaliteteve në zbatimin e kontratave etj.

c) Në **sektorin e doganave**, kanë rezultuar dëme financiare në vlerën e përgjithshme prej 959 milionë lekë konstatuar, nga trajtimi me transaksion të mallrave të importuar dhe keqklasifikim i kodit doganor të artikujve me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, nga pasaktësitë në llogaritjen e elementëve të vlerës për efekt taksimi doganor, nga vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me bazën ligjore të Kodit Doganor të RSH etj.

d) Gjithashtu, shkeljet me dëm ekonomik në fushën e të ardhurave kanë rezultuar edhe në sektorin e tatim-taksave, në vlerën e përgjithshme prej 113.6 milionë lekë, përgjithësisht kjo në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

**II. Dëmi ekonomik në fushën e shpenzimeve ka rezultuar në shumën prej 2,2 miliardë lekë, e cila përfshin shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime të ndryshme; shpenzimet për investime; ato operative dhe shpenzime të tjera.**

*Dëmi ekonomik i evidentuar në shpenzimet e sektorit të investimeve përbën 76 % të dëmit në fushën e shpenzimeve. Ky dëm ekonomik ka rezultuar në fushën e prokurimit të nevojave për mallra/shërbime/investime publike, si në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ashtu edhe në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.*

KLSH ka evidentuar problematika të shumta në procedurat e prokurimit, që nga llojet e procedurave me tendencë drejt atyre me negociim të drejtpërdrejtë, përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike të ekzagjeruara jo në raport me objektin e kontratës, të vepruarit e zyrtarëve të prokurimit me dy standarde etj., duke sjellë për pasojë mungesën e konkurrencës së nevojshme për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin me eficiencë të përdorimit të fondeve publike. Mjafton të cilësojmë se në periudhën dy vjeçare 2018-2019, nga auditimet ka rezultuar dëm ekonomik në fushën e prokurimeve 2.8 miliardë lekë dhe mungesë efektiviteti të këtij fondi për vlerën prej 55.1 miliardë lekësh

Në mënyrë më të detajuar, problematikat e konstatuara nga auditimet lidhen jo vetëm me planifikim jo të drejtë të nevojave, por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Mangësitë i referohen zbatimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik, për shkak edhe të mangësive profesionale të zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve publike konstatohet si shkelje në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/ përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik; paraqitjen dhe pranimin e ofertave; hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në konkurim; në njoftimin e fituesit, në procedurat e prokurimit me një ofertues, në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët, arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar; zbatimin e kontratave nga kontraktorët në përputhje me kushtet e përgjithshme etj. Nga vlera e mësipërme e dëmit ekonomik, 75 % i përket zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.

Abuzimet në fushën e prokurimit me fondet publike në thelb janë dhe më të larta, nga manipulimi ligjor, pasi ekziston dhe një shkallë dëmi e pamatshme nga prokurimet me një ofertues dhe me procedurat e negociimeve pa shpallje. (Kujtojmë këtu se për një pjesë të konsiderueshme të prokurimeve me prokurim direkt ose me një ofertues, nuk është metodologjikisht dhe praktikisht e mundur të përcaktohet dëmi ekonomik.). *Përfundimi i procedurave të prokurimit me një pjesëmarrës jo vetëm që ka ulur ndjeshëm konkurrencën e pjesëmarrësve dhe për pasojë efektivitetin në përdorimin e fondeve publike, por ka çuar gradualisht në krijimin e monopoleve në tregun e prokurimeve publike për sektorë të ndryshëm, por kryesisht në sektorët e ndjeshëm të shërbimit për qytetarin.*

Në këtë aspekt, kanë një rëndësi rekomandimet e institucionit të KLSH për përmirësimet e legjislacionit të prokurimeve publike. Kështu, **nisur nga numri i lartë i procedurave të prokurimit me një pjesëmarrës dhe fitues**, KLSH i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, për domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore në vlefshmërinë e procedurave të prokurimit me fondet publike, në jo më pak se dy operatorë ekonomikë pjesëmarrës që plotësojnë kriteret e kualifikimit. Kështu, vetëm gjatë vitit 2018 rezultojnë **8400 procedura me vlerë mbi 800 mijë lekë të shpallura nga sistemi elektronik i prokurimit**, (ku në 2353 raste ato janë anuluar dhe në 6047 të tjera është vijuar procedura). **Numri i procedurave të përfunduara me një operator dhe finalizuar me lidhje kontrate janë 1686, ose 33 % e numrit të procedurave që kanë vijuar rregullisht, me vlerë 35,214,459.376 lekë, ose e barabartë me 27 % të vlerës gjithsej të fondeve të prokurimit<sup>1</sup>.**

---

<sup>1</sup> -Shkresa e KLSH me nr. 94/2 prot., date 17.1.2020, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë



**III. a.- Për vitin 2019, shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave për subjektet e audituara, janë në vlerën 46,632,192 mijë lekë.** Sipas klasifikimit të fushave përkatëse rezulton se në pjesën më të madhe prej 90 % i përkasin sistemit tatimor dhe pjesa e tjetër kryesisht në sistemin doganor, por nuk mungojnë dhe shkelje të tilla në administrimin e pronës publike, urbanistikë etj.

**III. b.- Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion, për vitin 2019 arrijnë në shumën prej 83,879,401 mijë lekë.** Ato kanë rezultuar në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në fushën e keqmenaxhimit të fondeve të programuara për shpenzime operative, në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor. Bazuar në rezultatet e auditimeve, konstatohet se kjo shkelje e disiplinës financiare është e përhapur kryesisht në zbatimin e kontratave (investime në vlerën prej 46,093,897 lekë) dhe tek shpenzimet operative (24,346,184 lekë), por nuk mungojnë shkelje të tilla as tek procedurat e prokurimit etj.

#### **IV. Risqe të mundshme që duhet të jenë në vëmendjen e qeverisë.**

Gjatë vitit 2019, KLSH ka evidentuar se ekzistojnë risqe të mundshme që kërcënojnë financat publike dhe që ndikohen nga vendimmarrjet e çështjeve gjyqësore të hapura pranë gjykatave ndërkombëtare, procese në të cilat vendi ynë është palë, ashtu edhe ato të lidhura me kontratat koncensionare apo efektet e partneritetit publik-privat.

Duhet theksuar se, nga auditimi i disa projekteve koncesionare / PPP në kuadër të implikimeve fiskale për Buxhetin e Shtetit mbi përballueshmërinë, qendrueshmërinë, fizibilitetin fiskal dhe risqet e marra përsipër nga sektori publik, bazuar kjo edhe në ndjeshmërinë e rritur të opinionit publik, janë identifikuar anomali dhe shkelje për të cilat, KLSH i është drejtuar zyrtarisht Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit,<sup>1</sup> duke i kërkuar rishikimin e **dy kontratave koncesionare deri në anulimin e tyre**, lidhur kjo edhe me situatën e vështirë për financat publike post-tërmetit.

#### **2.3.-Rekomandimet dhe masat e propozuara. Zbatueshmëria e tyre.**

Parimet klasike të auditimit të jashtëm publik përcaktojnë se SAI-et auditojnë dhe rekomandojnë masa përkatëse të karakterit të përmirësimit të kuadrit ligjor, organizativ, administrativ (rekomanduar organeve përkatëse për marrjen e masave të tilla), për shpërblim dëmi, masat për eliminimin e

---

<sup>1</sup> Shkresa e KLSH me nr. 666 prot., date 10.09.2019

efekteve nga përdorimi i fondeve publike pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet, ato disiplinore, etj.;, në përputhje kjo dhe me tagrin kushtetues, në dobi të mirëqeverisjes, por që nuk kanë attribute urdhëruese për subjektet e auditimit.

Në varësi të natyrës dhe impaktit të gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit, kur janë vlerësuar elementë të veprës penale janë kryer kallëzime në prokurori ose indicie për çështje të tilla pranë strukturave të prokurorisë.

**Gjatë vitit 2019 janë rekomanduar 100 masa për ndryshime apo përmirësime ligjore, 2593 rekomandime me karakter organizativ, si dhe 713 rekomandime disiplinore dhe administrative.**

Nga 100 rekomandime që prekin përmirësime për amendime në kuadrin ligjor, raportimin financiar por edhe në përmirësime të kornizës rregullative të institucioneve me synim forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike etj. janë pranuar 23 prej tyre dhe 77 janë në proces pranimi.

*Në këtë kuadër, duke iu rikthyer dhe një herë gjetjeve në fushën e prokurimeve publike, KLSH ka kërkuar përmirësime ligjore duke iu drejtuar legjislativit (Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit të Ekonomisë dhe atij të Ligjeve) për vendosjen e kushtit ligjor për numrin minimal të dy operatorëve ekonomik pjesëmarrës të kualifikuar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, gjë që jo vetëm do të ngushtojë hapësirat e autoriteteve kontraktore në përcaktimin e kriterëve të veçanta subjektive për përzgjedhjen e operatoreve ekonomikë, me qëllim përfitimet e paligjshme dhe korruptive, por edhe do të rrisë konkurrencën dhe përdorimin me efektivitet të fondeve publike*

Gjithashtu KLSH nga 2593 masat organizative të rekomanduara, në drejtim të forcimit të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit, rezulton se 766 masa janë pranuar dhe 1827 masa janë proces pranimi.

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara ka adresuar rekomandimet për masat disiplinore dhe administrative, subjekteve të audituara dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në media-n e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodin e Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e **713 masave disiplinore dhe administrative.**

**Përsa i përket nivelit të zbatimit të rekomandimeve për auditimet e kryera gjatë vitit 2019, kjo çështje i përket vijimësisë së veprimtarisë së këtij viti.**

**Megjithatë, referuar zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018, bazuar dhe në informimin e vazhdueshëm që KLSH i ka bërë Kuvendit të Shqipërisë për këtë çështje për të influencuar në zbatimin e tyre,**

**rezulton se, krahas mospranimit të 5 % të tyre, janë zbatuar plotësisht vetëm 52.2 % e tyre.<sup>1</sup>**

Nga sa më sipër, konstatohet se pavarësisht insistimit të vazhdueshëm të KLSH për zbatimin në kohë të masave të rekomanduara, si nëpërmjet auditimeve të veçanta ashtu edhe atyre të radhës, të cilët kanë pasur çështjen e parë zbatimin e rekomandimeve, **përgjegjshmëria e menaxherëve dhe zyrtareve të lartë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit vijon të mbetet ende e ulët.**

Në referencë me kërkesat e Nenit 11, të ISSAI 1, “Deklarata e Limës me udhëzimet për rregullat e auditimit”, “...Institucioni Suprem i Auditimit, duhet të fuqizohet për ti kërkuar autoritetit që është përgjegjës marrjen e masave të nevojshme dhe palës përgjegjëse të pranojë përgjegjësitë”, KLSH për më shumë se një herë dhe në mënyrë të përsëritur i ka sugjeruar qeverisë hartimin e **ligjit për përgjegjësinë materiale të menaxherëve publikë**, sipas të cilit, autoritetet dhe institucionet të mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre. Plotësimi i kuadrit legjislativ me ligjin për përgjegjshmërinë publike dhe materiale të menaxherëve dhe zyrtarëve të tjerë, do ti japë kuptim të plotë edhe reformës në drejtësi, nëpërmjet adresimit të duhur të përgjegjësive ligjore e materiale nga abuzuesit e fondeve të shtetit.

#### **2.4.- Kallëzimet penale**

KLSH në 8 vitet e fundit, 2012-2019, ka përcjellë **337 Kallëzime Penale për 999 persona** që kanë pasur në qendër të vëmendjes luftën ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes si dhe të mashtrimit financiar në përdorimin e fondeve dhe të pasurisë publike, duke synuar rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publik, si dhe të efekteve parandaluese nëpërmjet ndëshkimit të personave të cilët janë vlerësuar se gjatë veprimtarisë tyre kanë pasur elementë të veprës penale.

KLSH nga auditimet e realizuara në vitin 2019 ka përcjellë 28 kallëzime dhe indicie penale, dhe janë në proces shqyrtimi dhe vlerësimi nga Departamenti Juridik në KLSH dhe 2 praktika auditimi.

### **3.ANALIZA FAKTORIALE SWOT.**

Performanca vjetore e institucionit, është një përmbledhje e rezultateve kryesore të arritura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij për periudhën Janar - Dhjetor 2019. **KLSH, si një institucion modern i auditimit të jashtëm, progresin e rezultateve të arritura e ka bazuar në vlerësimin analitik të faktorëve avantazhues që ndihmojnë, si dhe atyre**

---

<sup>1</sup> Shkresa e KLSH me datë 31 dhjetor 2019, përcjellë Kuvendit, mbi raportin e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018

**që e frenojnë apo e pengojnë veprimtarinë e saj, nga pikëpamja e të gjithë burimeve të brendshme e të jashtme, si dhe duke u fokusuar qartësisht në qëllimet, objektivat dhe në sfidat e së ardhmes.** Një analizë e tillë SWOT (**S**trength- Fuqitë, **W**eakness- Dobësitë, **O**pportunities- Mundësitë, **T**hreats-Kërcënimet) identifikon dhe zbërthen këto elemente, me preokupimin për minimizimin e dobësive dhe kërcënimeve si dhe kthimit të oportuniteteve në një avantazh dhe përparësi / fuqi efektive në dobi të veprimtarisë audituese të KLSH.

Pa u ndalur në mënyrë të hollësishme në të gjitha **elementët e fuqisë së KLSH**, ndër më kryesorët, cilësojmë:

- Është më se e kuptueshme që ndër fuqitë kryesore të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë *mandati i saj kushtetues* lidhur me pavarësinë institucionale, fokusin e punës dhe detyrat funksionale, si dhe *Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”*, i cili jo vetëm forcon pavarësinë financiare të KLSH-së, konsolidon pavarësinë organizative, zgjeron sferën audituese të KLSH-së por dhe specifikon aksesin në grumbullimin, analizimin dhe publikimin e informacionit, duke adresuar transparencën në komunikim, me theks në etikën e integritetin profesional të punonjësve dhe ekspertëve të KLSH-së.

- Në vijim të fuqive jo më pak e rëndësishme, mbetet *Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022, e cila i përgjigjet kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të INTOSAI-t (ISSAI-ve), është e mbështetur në udhëzuesit metodologjikë të publikuar për këtë qëllim nga organizatat ndërkombëtare profesionale dhe Nisma për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), si dhe në Planet Strategjike të INTOSAI-t 2017-2022 dhe EUROSAT-t 2018-2023, të miratuara në Kongreset përkatëse.*

- *Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI)*, për të cilët bëhen përpjekjeje maksimale për zbatimin në punën audituese, dhe që janë një element i fuqishëm në këtë analizë, tashmë janë përkthyer, përshtatur dhe publikuar nga vetë KLSH, në funksion të rritjes së integritetit të menaxhimit të procesit auditues dhe forcimit të përgjegjshmërisë gjatë veprimtarisë audituese.

Kështu, referuar **raport progresit të KE për Shqipërinë**, datë 26.5.2019, kapitulli 32 “Kontrolli Financiar”, në lidhje me këtë aspekt theksohet se:

“Kwadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (SAI), në linjë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).<sup>1</sup>

Në linjë me këto prosperime, janë miratuar dhe janë në funksionim një kuadër i brendshëm rregullator administrativ e organizativ, së bashku me Manualet dhe udhëzuesit specifikë në funksion të zbatimit në praktikë të

---

<sup>1</sup> [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), Njoftime: Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në Progres Raportin 2019

Standardeve ISSAI. Në dorë të audituesve të KLSH numërohen sot **mbi 15 guida kryesore dhe manuale metodike** sipas tipologjive të auditimit publik, që i shërbejnë zbërthimi të panelit INTOSAI GOV në përditshmërinë dhe praktikën e punës audituese.

- *Në aspektin organizativ jo vetëm që ka një shtrirje të konsiderueshme të fuqive, por edhe një hierarki të qartë të roleve dhe përgjegjësive për arritjen e objektivave institucionalë, shprehur në konsolidimin e plotë të Departamentit të Auditimit të Performancës, dhe krijimin e Departamentit të Auditimit të IT. Përveç sa më sipër, janë edhe investimet për rritjen e kapaciteteve audituese në tërësi, përdorimi i instrumenteve të duhura për rritjen e integritetit dhe të etikës së stafit auditues, duke vazhduar me kulturën institucionale të lidhshme në favor të transparencës dhe llogaridhënës brenda dhe jashtë KLSH-së, motivimin dhe promovimin për rritjen në karrierë dhe deri tek menaxherë me grada shkencore, përvojë të gjatë institucionale dhe njohuri të thelluara në fushën e auditimit, aplikimin e testeve periodike për rifreskimin kontrollin dhe shtimin e njohurive audituese, etj*

*.. Gjithashtu, ekziston një kornizë rregullative dhe udhëzuese si korpus i plotë me rregullore, manuale, udhëzues, sistem elektronik të menaxhimit të auditimeve në kohë reale, etj.*

- Trajnimet e përditësimit të njohurive, të ofruara nga partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë, që në fund të vitit 2019, audituesit e KLSH kanë marrë pjesë mesatarisht në **25 ditë trajnimi për auditues**, indikator i cili rezulton të jetë **12 herë më i lartë se viti 2009** ku kishte vetëm 2 ditë mesatare trajnimi .

Gjithashtu në total janë **23 auditues** të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA, si dhe nga bashkëpunimi i suksesshëm me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO) ka vazhduar pjesëmarrja e audituesve tanë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre dhe e kanë përfunduar këtë program **6 auditues**

- Duhet vënë në dukje që politikat e rekrutimit të punonjësve janë një faktor avantazhues në lidhje me progresin e deritanishëm në veprimtarinë audituese të KLSH-së pasi është arritur që mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2019 është 42.6 vjeç, nga 52 vjeç në vitin 2011.

- Veç sa më sipër, një epërsi në vijim e veprimtarisë së KLSH kanë qenë *botimet profesionale dhe shkencore në lëmin e auditimit, si edhe prania e rritur në mënyrë të vazhdueshme e audituesve në median e shkruar.*

Në kërkim dhe analizë të përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë audituese të KLSH, ne **kemi hulumtuar dhe analizuar edhe dobësitë tona.** Kështu,

- Pavarësisht rezultateve të arritura, *implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit mbetet ende një sfidë institucionale, jo vetëm për*

ne, por për çdo SAI modern. Vështirësitë qëndrojnë jo vetëm në mungesën e një studimi dhe përvetësimi të kujdesshëm dhe integral të ISSAI-eve nga të gjitha strukturat brenda KLSH-së, por dhe në interpretimin e tyre brenda kontekstit shqiptar të auditimit të aktivitetit ekonomik publik,.

- *Studim i pamjaftueshëm i dokumenteve audituese dhe qasje jo e plotë ndaj problemeve të konstatuara*, evidentohet për shkak të dobësisë në thellim të evidencës audituese, të mangësive në teknikat e mbledhjes dhe analizimit të informacionit, duke çuar në një qasje reaktive ndaj problemeve të konstatuara.

- Gjithashtu, konsiderohen dobësi edhe ineficenca heurarkike në disa hallka, mungesa e kapaciteteve të stafit auditues, rezistenca e ndaj ndryshimeve për të ndryshuar traditën e trashëguar, vështirësi në përthithjen e qasjes inovative në auditime etj.

Megjithëse **mundësitë** janë të shumta si: promovimi dhe motivimi mbi bazën e rezultateve në punë (vlerësimi i aftësive, shpërblimin moral dhe material); rritja e përgjegjshmërisë së punës në grup (përkushtimit më të madh dhe rritjes së shanseve për sukses); rritje e impaktit në publik, për shkak të kufizimit të ndikimit nga ndërhyrjet e jashtme (shtimi i influencës së raportimeve, duke u ngritur profesionalisht mbi këtë premisë, e kombinuar me rritjen e kapaciteteve të stafit auditues); inkurajimi i institucioneve homologe, organizatave, shoqatave të ndryshme dhe njësisë akademike për aktivitete të përbashkëta trajnimi, auditimi paralel dhe shkëmbimi eksperience etj., të gjitha këto janë mjaft të rëndësishme në aktivitetin e KLSH, Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë merr dhe analiza e raportit të fundit mbi INTOSaint - vetëvlerësimin vullnetar të integritetit- (*proces ky i kryer gjatë javës së kaluar në KLSH*), duke i shndërruar në një mundësi potenciale rekomandimet e këtij raporti, me qëllim fillimin e praktikave të auditimit të integritetit sipas këtij kuadri.

Padyshim që veprimtaria e KLSH, në rrafshin e analizës SWOT ka dhe **kërcënimet** e veta, të cilat mund të kenë ndikuar në frenimin e progresit në këtë drejtim.

Kështu mund të përmendim:

- 1. Duhet theksuar se viti 2019, është karakterizuar nga një dukuri, veçori juridike dhe kushtetuese që është jashtë attributeve, jurisprudencës, kontrollit dhe influencës menaxheriale të këtij institucioni, (e pa ndeshur më parë në gjithë historikun e këtij institucioni të pavarur), dhe e kushtëzuar nga mosarritja e një emëruesi të përbashkët të hallkave dhe autoriteteve më të larta shtetërore për dekretimin dhe miratimin e Kryetarit të Ri të KLSH përgjatë vitit 2019. Kjo situatë, dashur - pa dashur, ka influencuar në mënyrë indirekte e në një farë mase, impaktin dhe rezultatet e institucionit në vitin e kaluar dhe në vijimësi.

Kjo situatë e drejtimit të KLSH-së me qëndrimin në detyrë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, në përputhje me kërkesat e nenit 24 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në një farë mënyre e ndikon vijueshmërinë normale institucionale. Në këto kushte, në emër të gjithë audituesve të KLSH u bëj thirrje Presidentit të Republikës dhe maxhorancës qeverisëse që të përshpejtojnë proceset e zgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH, me qëllim, që efektet e këtij kërcënimi të zbuten dhe minimizohen, duke shprehur vullnetin tim për sigurimin e vazhdimësisë deri në ardhjen e titullarit të ri të institucionit, referuar kuadrit ligjor aktual.

Në lidhje me sa sipër, unë si Kryetar i KLSH-së edhe sot kam një qëndrim të pandryshuar, të shprehur edhe në Kodin Etik të Kryetarit të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 27, datë 20.4.2018, adresuar zyrtarisht Presidentit të Republikës përmes kërkesës time për mos rikandidim për tu ri zgjedhur në postin e Kryetarit të KLSH-së, për të cilën kam bërë me dije dhe autoritetet e larta shtetërore përfshirë Kuvendin e Shqipërisë.

- 2. *Perceptim i deformuar i opinionit publik, palëve të interesit dhe subjekteve të audituara, pavarësisht angazhimit të KLSH në fushën e komunikimit, kërcënon arritjen e një sërë objektivash të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së. Nga analizat dhe vlerësimet tona, del se në shumë raste nuk ka një kuptim të drejtë mbi funksionin e KLSH, pasi ne nuk bëjmë politika , nuk zbatojmë politika dhe nuk kemi funksione ekzekutive, por vetëm rolin rekomandues, siç kemi vepruar deri më tani dhe në vijim.*

- 3. *Vazhdon të mbetet ende problem zbatimi dhe ndjekja e rekomandimeve që KLSH iu ngarkon institucioneve dhe enteve publike të audituara, duke cenuar rezultatet e veprimtarisë audituese të KLSH-së, duke furnizuar antikulturën e pandëshkueshmërisë;*

- 4. *Numri i lartë i auditimeve, spektri i zgjeruar i llojeve të auditimit dhe hera-herës aplikimi i kombinuar i tyre, përbëjnë risk për rënie në gabime, dhe si të tilla kërkojnë menaxhim të kujdesshëm nga stafi audituese e drejtues në KLSH.*

- 5. *Përplasjet politike në vend, në lidhje me ngadalësimin e proceseve të zgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH.*

- 6. *Pamjaftueshmëria kapacitetesh njerëzore të specilaizuara dhe logjistike për të mbuluar me auditim të gjitha institucionet dhe entet publike, sjell për pasojë që përzgjedhja e subjekteve dhe temave audituese të bëhet në përputhje me burimet e kufizuara në dispozicion.*

## **2019 - VITI I PROGRESIT NË IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2018-2022**

Viti 2019 shënoi vitin e dytë të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Periudhën 2018-2022.

Objektivat strategjikë të institucionit kanë avancuar dhe ecur paralel me objektivat e Planeve Strategjike 2017-2023 të EUROSAI-t dhe 2017-2022 të INTOSAI-t, dy organizatat e komunitetit të institucioneve supreme publike të auditimit në Evropë dhe botë. Monitorimi i zbatimit të kësaj Strategjie ka sjellë konsolidimin e reformës institucionale në KLSH dhe e ka rankuar dhe vendosur KLSH në panelin e institucioneve **bashkëkohore** e të **përparuara** të komunitetit të auditimit të jashtëm në Evropë. Bazuar në nivelin e treguesve të Kornizës së Matjes së Performancës së një Institucioni Suprem Auditimi, (dokument i miratuar si standard ISSAI në Kongresin e XXII të INTOSAI-t), rezulton se, objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022 për **dyvjeçarin 2018-2019** janë realizuar **në nivelin relativ prej 89 %**.

Për qëllim implementimi dhe monitorimi, plani strategjik i KLSH 2018-2022 është i ndarë në **3 prioritete strategjike (qëllime makro), që detajohen më tej në një rrjet prej 21 objektivash themelore**, të integruara dhe shtjelluara analitikisht më tej në **71 aktivitete, nënobjektiva dhe procese kapilare**. Këto 71 aktivitete dhe nënobjektiva formësojnë bazamentin e kësaj strategji dhe nga këto, t'vjetëm **66 aktivitete** dhe veprimtari i përkasin mbulimit të spektrit kohor 2018-2019, kurse **5 aktivitete** obligohemi ti zbatojmë pas vitit 2020. Kjo matricë tregon rrugëtimin e detajuar të veprimtarisë së institucionit tonë, për të implementuar strategjinë, aspekte këto që ndiqen çdo ditë, monitorohen dhe raportohen intensivisht sipas afateve të përcaktuara nga departamentet dhe strukturat përgjegjëse. Më lejoni të theksoj se, mosarritja prej **11 %** e disa indikatorëve të Strategjisë Sektoriale, është kushtëzuar nga faktorë objektivë jashtë institucionit tonë, që ndërliken dhe kushtëzojnë ritmin e këtyre avancimeve në reformë<sup>1</sup>. KLSH ka programuar disa indikatorë dhe aktivitete të ndërvarur nga veprimi i legjislativit, meqenëse në kohën e

---

<sup>1</sup> - Është në tagrin dhe autoritetin e institucionit të Kuvendit të Shqipërisë marrja në shqyrtim, e nismës për miratimin e ndryshimeve të propozuara nga ana e KLSH në ligjin organik, mbi aspekte të veçanta si certifikimi i audituesve të jashtëm të sektorit publik, heqja e kufizimit shtetëror në auditimin e fondeve publike të ofruara nga BE, saktësimin në ligj të kompetencës juridiksionale audituese të KLSH në auditimin e koncesioneve, partneritetit publik-privat, enteve rregullative etj. Kjo referuar shkresës së Kryetarit të KLSH nr.926, datë 02.08.2018 "Dërgohet projekt ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 154/2014...", (ridërguar Kuvendit me nr. 164, date 30.1.2020 si dhe DG Budget dhe Delegacionit të BE me datën 31.01.2020)



hartimit të Strategjisë së KLSH-së, besimi ynë ka qenë për veprime më energjike nga ana e Kuvendit të Shqipërisë për këto ndryshime e përmirësime ligjore të domosdoshme të rekomanduara prej nesh. Në një analizë të fundit, aprovimi i këtyre ndryshimeve sjell përafrimin më të plotë të legjislacionit e fushës së auditimit shtetëror me kërkesat e kuadrit "Acquis Communautaire", arsye kjo që na ka detyruar tu drejtohem sërish strukturave shtetërore kompetente duke ridizenjuar dhe përcaktuar afate të reja për implementimin e këtyre nënobjektivave dhe aktiviteteve.

Strategjia e Zhvillimit Institucional të KLSH për pesëvjeçarin 2018-2022 është ngritur mbi tri kolona që shënojnë dhe tre qëllimet prioritare mbi këndvështrimet e mëposhtme:

1. **Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6-E.**
2. **Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.**
3. **Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.**

Më hollësisht zhvillimi dhe implementimi i komponentëve të këtij dokumenti është si më poshtë,

📄 Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, **Objektivi i Parë Strategjik** lidhet me **rritjen e impaktit të punës audituese me fokus 6-E**. Në epiqendër të këtij qëllimi është forcimi i pavarësisë institucionale të KLSH. Aktualisht, KLSH ka një ligj organik bashkëkohor dhe tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të vitit 2014, me ndihmën e ekspertizës së Bashkimit Evropian. KLSH fokusoi përpjekjet për zhvillim institucional duke vendosur si qëllim të parë strategjik forcimin e pavarësisë në akord me parimet themelore të "**magna carta-s**" së auditimit, Deklaratës së Limës dhe Deklaratës së Meksiko-s, nëpërmjet përmirësimit të bazës rregullatore të tij, fakt i pranuar edhe nga autoritetet e ndryshme evropiane.

Kështu, referuar **raport progresit të KE për Shqipërinë**, datë 26.5.2019, kapitulli 32 "Kontrolli Financiar", faqe 99 në lidhje me këtë aspekt theksohet se:

"Kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (SAI), në linjë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).<sup>1</sup>

Në linjë me këto prosperime, janë miratuar dhe janë në funksionim një kuadër i brendshëm rregullator administrativ e organizativ, së bashku me Manualet dhe udhëzuesit specifikë në funksion të zbatimit në praktikë të

---

<sup>1</sup> [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), Njoftime: Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në Progres Raportin 2019

Standardeve ISSAI. Në dorë të audituesve të KLSH numërohen sot **mbi 15 guida kryesore dhe manuale metodike** sipas tipologjive të auditimit publik, që i shërbejnë zbërthimi të panelit INTOSAI GOV në përditshmërinë dhe praktikën e punës audituese.

Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet të ndërmarra për **përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës.**

Kuadri i ri ligjor dhe kushtetues ka zgjeruar gamën e auditimeve me lloje e tipologji të reja të përfshira me ligj, të pa njohura dhe të pa aplikuar gjer atëherë, *(si ato të performancës, të përdorimit të fondeve të BE-së, të teknologjisë së informacionit, të auditimit të mjedisit, auditimet e përbashkëta me partnerët etj)*. Kështu, upara pak vitesh u themeluan Departamentit e Auditimit të Performancës dhe ai i auditimit IT dhe për herë të parë iniciohen auditimet e IT (nga 2 angazhime të realizuara gjatë v.2015 dhe 2016, duke mbërritur në 7 auditime në vitin 2018).

Kështu startuan dhe morën kuptim në një terren të pashkelur, programimet e **auditimeve të performances**, meqenëse me miratimin e Ligjit 154/2014, KLSH u mandatua për të realizuar auditime performance në mënyrë eksplicite dhe specifike, me akses të pakufizuar, si në subjekte, ashtu edhe në informacion, sikurse dhe me të drejtën për të raportuar në Kuvend me auditime individuale performance. **Për vitin 2019, numri i auditimeve të performancës u rrit me 6% në krahasim me vitin 2016, si dhe u dyfishua ndaj vitit 2014 duke arritur në 16 auditime të kësaj tipologjie**

Me Objektivin e parë, KLSH provoi të kalonte me sukses sprovën drejt një zhvillimi ambicioz, atë të **auditimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit**. si një lloj i veçantë i auditimi nëpërmjet të cilit, KLSH mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive, duke përdorur burimet në mënyrë eficiente. Nën këtë objektiv, është krijuar Drejtoria e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe janë realizuar auditimet e para të këtij lloji, ndërkohë që është punuar për të miratuar kuadrin e plotë rregullativ dhe hartuar udhëzuesit metodologjik të nevojshëm, mbi të cilin realizohen auditime të tilla mjaft komplekse. **Auditimet e IT në vitin 2014 nuk aplikoheshin ende, ndërsa sot numri i tyre ka arritur në 7 auditime të dedikuara këtij lloji të veçantë auditimi , ose me një rritje prej 3 herësh ndaj numrit të auditimeve IT të kryera në vitin 2015, kuar ata startuan për herë të parë.**

📄 Qasja e institucionit në përmbushje të **Objektivit të Dytë Strategjik, Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese,**

**procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse**, u udhëhoq nga parimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

✓ Në përmbushje të këtij Objektiv, institucioni ka rritur kontributin **për qeverisjen e mirë për administrimin e burimeve publike**, duke synuar rritjen e transparencës dhe te llogaridhënies, **nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit**.

Në këtë plan, përgatitja e kallëzimeve dhe indicieve penale është konsideruar një gur themeli dhe një qëndrim konstant gjatë gjithë kësaj periudhe tetëvjeçare. KLSH po vlerëson **29 kallëzimet dhe indiciet penale** të vitit 2019\*, nga të cilat 23- prej tyre kanë përfunduar dhe dërguar prokurorisë, 2 prej tyre janë dërguar materialet për vlerësim prokurorisë dhe 4 janë në proces shqyrtimi nga KLSH. Veprat kryesore penale për të cilat akuzohen këta persona janë “Shpërdorimi i detyrës”, “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, por nuk mungojnë edhe akuza për “Falsifikim dokumentesh”, përveç sa janë rekomanduar masa disiplinore prej “Largim nga puna” dhe deri në “Vërejtje”, si për drejtues ashtu edhe për zyrtarë ekzekutiv.

Në epiqendër të këtyre kallëzimeve penale kanë qenë abuzimet me tenderat nga zyrtarët dhe entet publike e shtetërore, shpenzimet e pa-argumentuara dhe të ardhurat e munguara, abuzime me pronat publike e zyrtarë të korruptuar, keqmenaxhimi i financave publike, abuzimet dhe shkeljet e ligjshmërisë me prokurimet dhe parregullsitë gjatë procedurave të shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore i kanë kushtuar buxhetit të shtetit një dëm prej **645 miliardë lekësh** në dy vite, 2018-2019<sup>1</sup>. Përkatësisht, në sektorin publik në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në menaxhimin e financave publike, dëmi total për dy vitet e fundit arrin në shumën **363 miliardë lekë**. Problematikat e shumta në procedurat e prokurimit në periudhën 2018-2019 kanë regjistruar dëm ekonomik në vlerën **2.8 miliardë lekë**. Ndërsa në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore dëmi i shkaktuar buxhetit të shtetit i kalon **280 miliardë lekë**. Të tjera fenomene që ushqejnë kategoritë e korrupsionit janë: krijimi i barrierave oligopolistike në ekonomi; ngathtësia dhe paaftësia burokratike; niveli i lartë i papunësisë dhe përpjekje fiktive për ta zvogëluar atë nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të përkohshme te punës; niveli i përgjithshëm i çmimeve i krahasueshëm me vendet e zhvilluara evropiane, ndërsa niveli i pagave i krahasueshëm me vendet e pazhvilluara aziatike; potenciali ende i pa përmbushur i shoqërisë civile etj.

Të gjitha këtyre shkaqeve u duhet shtuar edhe fakti i krijimit të klimës së pandëshkueshmërisë së zyrtarëve të inkriminuar në praktika mashtruese dhe korruptive. Dënimet penale të parashikuara në legjislacionin tonë për

---

<sup>1</sup> - Intervistë për gazetën “Fjala” e kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z.Bujar Leskaj,

korrupsionin nga zyrtarët publikë janë të përgjithshme dhe krijojnë hapësira për shmangie. Pikërisht për të eliminuar këto hapësira, ne si KLSH prej më se 7 vitesh i kemi propozuar qeverisë dhe Kuvendit të kalojnë ligjin “Mbi përgjegjësinë materiale të zyrtarëve të lartë dhe të mesëm publikë”, i cili do të intensifikonte më tej luftën ndaj korrupsionit. Thënë ndryshe “do të vendoste pikat mbi ‘i’”. Duhet theksuar se sfidat për realizimin e proceseve integrale dhe angazhimeve të Agjendës së vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së (në këtë proces ne si Shqipëri jemi shumë mbrapa), kërkojnë bashkëpunim efektiv të të gjithë aktorëve dhe faktorëve kryesore në vend, me objektiv zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes mirëqeverisjes, llogaridhënies dhe sinergjizimit të politikave dhe aksioneve kombëtare.

Në frymën e kultivimit të kulturës së të mësuarit gjithë jetës, janë mbështetur veprimtaritë tona të kualifikimit, edukimit dhe trajnimit profesional. Në fund të vitit 2019, audituesit e KLSH realizuar një **mesatare prej 25 dite trajnimi / auditues**. Treguesi kryesor i progresit reflektohet në rritjen e numrit të trajnimeve që çdo auditues ka kryer gjatë vitit, duke arritur një **nivel të kënaqshëm prej 3611 ditë njerëz trajnime, ose referuar 145 audituesve efektive vjetorë, rezultojnë 25 ditë trajnimi mesatare vjetore për auditues** në vit, (kundrejt **2.1** të arritura në 2011 dhe **3.1** ditë trajnimi/person të kryer në vitin 2010), që shënon një rritje me **12 herë** kundrejt vitit 2011, kur ky tregues raportohej, ndonëse ishte minimal.

Vetëm gjatë 5 viteve të fundit kanë marrë pjesë në trajnime, seminare e workshope, grupe pune e konferenca, etj., **654 auditues dhe drejtues gjithsej**, të inkuadruar në **264 aktivitete**. **Internship-et** janë konsideruar një mjet eficient për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së. Në total janë **23 auditues** të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA. Bashkëpunimi i suksesshëm i iniciuar prej vitit 2012 me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA ka vazhduar me pjesëmarrjen të audituesve tanë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre dhe aktualisht e kanë përfunduar këtë program **6 auditues**

📖 Nën **Objektivin e Tretë Strategjik**, KLSH ka integruar elementë modernë të komunikimit dhe ka miratuar Strategjinë e Komunikimit 2017-2019, duke synuar të përçojë zërin e qytetarit dhe të publikut nëpërmjet auditimeve dhe raportimeve për gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Strategjia e komunikimit thekson marrëdhëniet e KLSH me publikun dhe Kuvendin, duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Sipas monitorimit të planit të veprimit të strategjisë së komunikimit rezulton që ajo është implementuar në masën 90%.

Objekti i tretë strategjik është orientuar dhe mbështetur në frymën e Parimit 8, të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit ISSAI 20, që nxit dhe inkurajon transparencën dhe përgjegjshmërinë, ku nënvizohet se “SAI-et komunikojnë

në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimit përmes mediave, faqeve të internetit dhe me mjete të tjera”. Këtu mund të ndalemi në disa dimensione të prekshme :

✓ 1.Për periudhën shtatë-vjeçare 2013-2019 të gjithë audituesit e KLSH-së kanë botuar në total **764 artikuj** në pothuajse në të gjitha gazetatat e vendit. Për të kuptuar dinamikën, mund të përmendim se për vitin 2019, 90 auditues, prej të cilëve rreth 30% janë auditues të rinj, kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetatat me 122 shkrime. Shkrimet e audituesve janë botuar në **12 volume** dhe përfaqësojnë fytyrën e punës sonë audituese për gjetje dhe problematika të dala gjatë auditimit duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit.

✓ 2.Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH-së në një numër prej **336 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike**. Komunikimi dhe bashkëpunimi me median vijon me të njëjtën frymë dhe intensitet dhe të gjitha mediat janë ftuar të marrin pjesë edhe në analizat vjetore të Departamenteve të auditimit, duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimtarisë së KLSH-së.

✓ Gjatë tetë viteve të fundit KLSH ka nënshkruar **60 marrëveshje bashkëpunimi**, nga të cilat 33 me OJF dhe Universitete Publike e Private, 17 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore. Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve është vlerësuar maksimalisht nga KLSH, duke bashkëpunuar ngushtësisht me personalitete të fushave të ndryshme, duke përfshirë një pjesë të tyre edhe në auditime specifike, që kërkojnë mendim më të specializuar. Kjo qasje bashkëpunimi me Universitetet konfirmohet edhe për vitin **2019, gjatë të cilit Kryetari i KLSH ka nënshkruar tre marrëveshje të reja bashkëpunimi me Universitete, përkatësisht me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universitetin “LOGOS” dhe “Albanian University”.**

✓ Edhe në vitin 2019, në zbatim të një prej objektivave të Strategjisë së Komunikimit të institucionit, KLSH organizoi për të tretin vit radhazi **Muajin e Hapur** për qytetarët në datat 1 nëntor-6 dhjetor 2019. Gjatë muajit të hapur audituesit e KLSH-së morën pjesë në shumë aktivitete brenda dhe jashtë institucionit,

✓ Gjatë vitit 2019 ne kemi vendosur në **WEB**, në kuadër të rritjes së transparencës vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për auditimet e realizuara përgjatë vitit 2019, në masën 90% (janë vendosur **124 vendime auditimi nga 140 auditime të realizuara**, ( nuk janë vendosur sepse janë konfidencialë) dhe janë vendosur gjithashtu edhe raportet respektive të auditimit. Gjithashtu në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2019 si Raporti i Aktivitetit, Raporti i Buxhetit, Raporti i Monitorimit dhe Buletinet Statistikore. Për të qenë sa më afër publikut, KLSH publikon në faqen e saj zyrtare të gjithë librat e kolanës së saj të botimeve

## KLSH dhe KUVENDI...

Me atë të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit, KLSH përveç përmbushjes së detyrimit kushtetues të **raportimit për zbatimin e buxhetit faktik nga Qeveria dhe raportimit mbi performancën e institucionit** ka synuar informimin e Kuvendit edhe përmes raporteve të veçanta të cilat paraqesin rëndësi të veçantë për publikun. Kështu, në akordancë me **ISSAI 12**, “Vlera dhe përfitimet e SAI-ve – të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve” dhe në respektim të plotë të **neneve 8 dhe 16, të ISSAI 1 “Deklarata e Limës”** (me udhëzimet për rregullat e auditimit) që njeh se SAI duke garantuar autonominë, vepron si bashkëpunëtor i legjislativit, nga ana e KLSH-së i janë përcjellë Kuvendit te Shqipërisë gjatë vitit 2019. **131 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2018 dhe 55 vendime e raporte auditimi për ato të kryera gjatë vitit 2019.** Po kështu, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve” KLSH edhe gjatë vitit 2019 i ka përcjellë Kuvendit **informacion lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit** të datës 19.07.2018. Një informacion më i detajuar për këtë çështje i është përcjellë periodikisht Kuvendit në **tre periudha** të ndryshme kohore, përkatësisht:

- Më datën **18 janar 2019**.
- Me qëllim informimin e Kuvendit lidhur me statusin e implementimit të rekomandimeve të KLSH lënë institucioneve të audituara dhe me synimin e mbështetjes së këtij të fundit për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e përdorimit të parasë publike, krahas raportit të performancës, KLSH me shkresën nr. 230/2, datë **08.04.2019** i ka përcjellë Kuvendit një raport të veçantë të detajuar për implementimin e rekomandimeve për periudhën tetor 2017- qershor 2018.
- Gjithashtu në **31 dhjetor 2019**, KLSH i ka përcjellë Kuvendit raportin e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018. Theksojmë se raportet e sipërcituara i janë përcjellë edhe Ministrit për Marrëdhëniet me Kuvendin. Përfaqësues të KLSH dhe përfaqësues të Komisionit për Ekonominë dhe Financat kanë marrë pjesë dhe kanë referuar lidhur me mënyrën si bashkëpunojnë institucionet tona edhe në aktivitete të ndryshme rajonale.

Të nderuar pjesëmarrës!

KLSH objektivitetin dhe pavarësinë institucionale e siguron përmes ushtrimit të mandatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj dhe në pajtueshmëri me standardet profesionale të auditimit, kodin e etikës dhe normat e sjelljes profesionale.

Në këtë mënyrë KLSH si agjent i Kuvendit ndikon në rritjen e besimit në shpenzimin e fondeve publike dhe luan një rol aktiv në rritjen e dimensionit të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë publike. Duke aplikuar kauzën e ISSAI 12 “Demonstrimi i vazhdueshëm i rëndësisë që ka SAI për qytetarët, parlamentin dhe palët e tjera të interesit”, KLSH evokon mbrojtjen e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera, duke qenë një kontribuues i transparencës e llogaridhënies në shërbim të mirëqeverisjes, si dhe burim i besueshëm e i dobishëm **informacioni** dhe **idesh**.

Dëshiroj të theksoj se gjatë vitit 2019, KLSH:

**A.** ka përmbushur përgjegjësitë e veta **kushtetuese**,

**B.** ka përmbushur detyrimin e saj **ligjor**,

**C.** ka përmbushur **misionin e saj auditues**, *duke*

demonstruar për një aktivitet që reflekton **pajtueshmërinë me ISSAI-t**, që aftëson dhe pajis audituesit me njohuritë dhe dijet e nevojshme për kryerjen e angazhimeve cilësore, në përputhje me Standardet dhe Praktikën më të mira Ndërkombëtare të Auditimit Publik; proces ky i konfirmuar, certifikuar dhe mbështetur si nga partnerët ndërkombëtarë me vlerësimet e tyre të pavarura, ashtu dhe nga Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, duke kontribuar në këtë mënyrë **drejtpërsëdrejti** edhe në proceset integruese të vendit.

Në nivel global, KLSH ecën në gjurmën e traditave të INTOSAI dhe është angazhuar me ambicien për të forcuar traditën e bashkëpunimit me partnerët me GAO dhe anëtarët e EUROSAT-t etj., duke e konsideruar këtë partneritet si një mundësi të pa zëvendësueshme dhe mjaft të rëndësishme për të bërë përpara. Nëpërmjet auditimeve dhe angazhimeve në grupe të përbashkëta të punës të këtyre forumeve, auditimeve të përbashkëta me SAI partnere etj., ne kemi zërin tonë dhe kontributet modeste rajonale e globale, ku integrohen dhe çështjet që lidhen me Axhendën 2030 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, për të cilat pareshtur kemi vëmë theksin tek sfidat e përbashkëta me të cilat ndeshemi sot, veçanërisht tek varfëria, pabarazia sociale, ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor, paqja, drejtësia dhe arsimimi etj.

Meriton një vëmendjen e posaçme dhe duhet të theksohet e të evokohet në këtë analizë vjetore fakti që: ky vit shënjon një progres të padiskutueshëm në

**planin e zhvillimeve mbarëkombëtare profesionale**, pasi, siç jeni në dijeni, në Kongresin e XXIII të INTOSAI-t<sup>1</sup> të mbajtur në Moskë në datat 23-27 Shtator 2019, u konfirmua propozimi i 20 shteteve anëtare në Bordin Drejtues të INTOSAI-t si dhe me mbështetjen e fuqishme të Zyrës së Auditimit Qeveritar të SHBA-së (GAO) dhe Kontrollorit të Përgjithshëm z.Gene Dodaro, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, falë përpjekjeve dhe angazhimit të Auditorit të Përgjithshëm z.Besnik Osmani, pranohet anëtarja e **194** me të drejta të plota në familjen e INTOSAI-t.

## **SFIDAT DHE ANGAZHIMET TONA PËR TË ARDHMEN....**

Për vitin 2020 e në vijim prioritare për KLSH do të vijojë të jetë implementimi i standardeve ISSAI dhe Kuadrit të Integruar të Praktikave Profesionale (*IFPP INTOSAI - INTOSAI Framework of Professional Pronouncements*) si një proces dinamik, pasi dhe vetë zhvillimi i standardeve profesionale të auditimit është i tillë, kjo në përgjigje dhe reflektim të shndërrimeve në nivel global. KLSH riafirmon angazhimin konstant në zbatimin e kuadrit të plotë të INTOSAI-t dhe në zbatim të detyrave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, të Korrikut.2018, prioritetet në veprimtarinë tonë audituese do të synojnë:

1. KLSH do të vijojë qasjen e auditimit të jashtëm të bazuar në risk, e iniciuar për herë të parë në qershor 2018. Në zbatim të rekomandimeve të Progres Raportit të Këshillit të Evropës<sup>2</sup>, do të synohet rritja e numrit të auditimeve të performancës dhe atyre të IT në totalin e auditimeve të KLSH me prioritet të theksuar ndaj tyre.
2. Auditimet financiare do të rezultojnë me opinione të auditimit profesional, duke përfshirë dhe dhënien e opinionit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, proces i filluar që në v.2017. Përmirësimi i cilësisë së auditimit, në qëllimin që aktivitetet e auditimit të zbatohen në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit..
3. Intensifikimi i proceseve të Zbatimit të Rekomandimeve, në frymën e Parimit nr. 7 të Deklaratës së Meksikos<sup>3</sup>. dhe Udhëzimit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, duke reflektuar përmirësimet e kuadrit rregullator dhe funksional të KLSH-së.

---

<sup>1</sup> -INCOSAI XXIII, Moske

<sup>2</sup> -Albania 2019 Report, Bruksel 29..5.2019

<sup>3</sup> -ISSAI 10, miratuar nga INCOSAI XIX, 2007, Meksikë



4. Zbatimi i dokumentit të politikave mbi Burimeve Njerëzore, ku janë përfshirë nëntë elementët e tij përbërës, dhe mund të nënvizojmë si rekrutimet e audituesve me përvojë, forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit, domosdoshmërinë e kulturës së edukimit të vazhduar, promovimin e vlerave etike të stafit, etj .

5. Në fushën e Kontrollit të Cilësisë për KLSH , roli ynë në përputhje me ISSAI 40, do të jetë duke i dhënë rëndësinë e duhur monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së angazhimeve si dhe realizimit të përvitshëm të procesit të kontrollit të cilësisë në të ftohtë, dhe angazhimit të KLSH ndaj parimeve etike.

6. Në aspektin e metodologjisë dhe zhvillimit, fokusi ynë do të jetë rishikimi dhe përmirësimi i manualeve dhe metodologjive, duke finalizuar në bashkëpunim me SIGMA-n, Udhëzuesin për auditimin e buxhetit të shtetit.

7. Vijimësia e masave për të përmirësuar zhvillimin profesional të stafit të auditues. KLSH në zbatimin e planit të zhvillimit strategjik 2018-2022 dhe strategjisë së komunikimit 2017-2019 synon forcimin e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional të audituesve, duke ruajtur akordin e 25 ditëve trajnim profesional mesatarisht në vit, sipas programit të integruar të zhvillimit profesional të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 187, datë 31.12.2019.

8. Organizimi dhe mbajtja e Konferencës së VII-të Ndërkombëtare të KLSH-së me objekt “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 2030 dhe Shqipëria”.

9. Avancimi në aplikimin e softwareve në funksion të auditimit (rasti ynë me SIMMPA), si dhe përmirësimi e rishikimi i rregullores së procedurave të auditimit të KLSH, në drejtime të veçanta si mbi formulimin e opinionëve të auditimit dhe standardizimin e letrave të punës, etj.

10. KLSH do të vazhdojë impenjimin në shkëmbimin e përvojave ndërkombëtarisht, përmes pjesëmarrjes në tryezat e grupeve të punës së EUROSAI dhe INTOSAI-t; kryerjes së auditimeve pilote, paralele dhe të përbashkëta me SAI partnere, sipas motos së INTOSAI-t, se “nga përvojat e përbashkëta përfitojnë të gjithë”. Nën këtë okeljo, KLSH konsideron primare shkëmbin ndërkombëtar të eksperiencave, sipas definimeve të nenit 15 të ISSAI 1, duke qenë një pjesëtar aktiv, nëpërmjet kontributeve dhe angazhimit në grupet e punës së EUROSAI-t dhe në takimet rajonale me dobi të përbashkët.

Veç sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucioni më i lartë ekonomiko-financiar do të udhëhiqet nga parimi i përmbushjes së detyrimeve kushtetuese duke vepruar si **agjent i Kuvendit** për të siguruar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e parasë publike nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale.

Duke e përmbyllur fjalën time, që t' Ju japim më shumë frymë dhe kohë diskutimeve të drejtuesve dhe audituesve të institucionit, Ne si institucion suprem i auditimit shtetëror, do të vijojmë përpjekjen e pandryshuar që,

“të jemi shërbëtarë dhe mbrojtës të interesave të qytetarëve shqiptarë, synojmë përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike”,

si dhe do të vendosim në prioritetet tona të ardhshme direktivën e Kongresit të fundit të INTOSAI-t, sipas së cilës,

“ SAI-t inkurajohen të **edukojnë audituesit e së ardhmes....**dhe të veprojnë si

- **Aktorë strategjikë,**
- **Shkëmbyes të njohurive** dhe
- **Prodhues të largpamësisë ”...**

Ju faleminderit!